

LIGJ
Nr.7567, datë 25.5.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7504, DATË 30.7.1991 "PËR POLICINË E RENDIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Neni 36 ndryshohet si vijon:

"Në organet e policisë së rendit pranohen për policë, mbi baza vullnetare dhe me kontratë, shtetasit shqiptarë që plotësojnë këto kërkesa:

- Të kenë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të kenë kryer shërbimin ushtarak.
- Të mos jenë të dënuar me heqje lirie.
- Të plotësojnë kushtet e konkursit për polic.
- Të plotësojnë kushtet shëndetësore, fizike dhe gjatësinë mbi 1.70 cm, si dhe të jenë të moshës gjer në 30 vjeç.

Me miratimin e ministrit të Rendit Publik, kur komisioni mjekësor e ka parë të përshtatshëm, mund të pranohet polic edhe shtetasi me moshë mbi 30 vjeç gjer në 40 vjeç.

- Të kenë figurë të pastër morale ".

Neni 2

Në nenin 38, mbas paragrafit të parë, shtohet paragrafi:

"Për të përndjekurit politikë (të dënuar e të internuar) mjafton arsimi i mesëm. Kriteri i moshës për këtë grup personash nuk merret parasysh".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.196, datë 29.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha